

KËRKIME GJUHËSORE

Mirela PRIFTI

ELEMENTE ÇERDHORE TEK FJALORË TË ANGLISHTES DHE TË SHQIPES

Në fokusin e këtij studimi janë veçoritë dhe vlerat e gjithanshme të fjalorëve në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Kjo e fundit është një gjuhë me karakter e përmasa botërore. Ajo është gjuha që mësohet dhe kuptohet më së shumti në botë dhe shpesh njihet edhe me epitetin “gjuha e tregtisë, arsimit, shkencës dhe diplomacisë”.

Gjatë procesit të përvetësimit të anglishtes, por edhe gjatë përkthimeve të panumërta, shqipfolësi në përpjekje për ta nxënë a për ta zotëruar këtë gjuhë, përballat së pari me strukturën leksikore e semantike të saj. Duhet theksuar fakti se anglishtja jo vetëm është një nga gjuhët me nivelin më të lartë të standardizimit, por edhe nga fondi i mjeteve të shprehjes *ajo është shumë më e gjerë dhe shumë herë më e pasur se shqipja*. Marrëdhëniet e shqipes me anglishten, në ditët e sotme, janë shumë komplekse. Ajo është si gjuhë e dytë e detyruar në të gjitha hallkat e sistemit universitar dhe janë shumë të pakta universitetet që nuk kanë degë të veçantë diplomimi anglishten. Në provimet e pranimit për në shkollën e lartë, në nivelin e provimeve të maturës shtetërore e në studimet pasuniversitare, anglishtja është një nga provimet më me përparësi.

E gjithë kjo situatë e çon shqiptarin anglishtfolës së pari *tek fjalori* dhe *tek gramatika* e anglishtes, si dy shtyllat kryesore të mësimin të një gjuhe të huaj. Fjalorët, si një nder mjetet me thelbësore dhe të rëndësishme në këtë proces, janë të llojeve të ndryshme, të tipeve të ndryshme, dhe të hartuar sipas teknikave të ndryshme leksikografike. Sipas një tradite tashmë të afirmuar në leksikografinë angleze, ku organizimi çerdhorë është teknika kryesore e zërave leksikografikë, edhe në Shqipëri, në fillim të shekullit XXI (në vitin 2006) doli në qarkullim *Fjalori i gjuhës shqipe*, që është hartuar sipas kriterëve dhe teknikave të tilla.

Fillimisht, na duhet të theksojmë se *leksikografia e një gjuhe* nënkupton teorinë dhe praktikën e hartimit të fjalorëve të llojeve dhe të tipave të ndryshëm. Duke u mbështetur *te lloji i informacionit*, njihen dy lloje fjalorësh: a. *Fjalorë gjuhësorë*; b. *Fjalorë jogjuhësorë*. Fjalorët gjuhësorë mund t'i grupojmë: a. *Fjalorët njëgjuhësh*; b. *Fjalorët dy- dhe shumëgjuhësh*. Sipas *gjerësisë dhe vëllimit*, fjalorët shpjegues janë tre tipash. *Fjalorë integralë*; b. *Fjalorët e tipit të mesëm*; c. *Fjalorët e vegjël*. Sipas *lëndës* që pasqyrojnë, fjalorët mund të jenë të përgjithshëm, fjalorë fjalësh frazeologjikë, sinonimikë, antonimikë, terminologjikë, onomastikë, të autorëve, shkollorë, të fushave të veçanta etj.; D. Sipas mënyrës së paraqitjes së lëndës leksikografike fjalorët mund të jenë *alfabetikë, inversivë, çerdhorë*. Këta janë *tematiko-paradigmatikë* ose *ideografikë* dhe *teamtiko-sintagmatikë*. Nëse i referohemi historisë së leksikografisë shqipe, ajo ndahet në dy periudha kohore: a. Periudha që fillon me botimin e fjalorit të parë të shqipes të njohur deri tani (Fjalori latinisht – shqip i F. Bardhit, 1635) e vjen deri në gjysmën e dytë të shekullit XX (kur përfundon Lufta II Botërore). b.

MIRELA PRIFTI

Periudha e dytë që zë fill pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore (gjysma e dytë e shekullit XX) e deri në ditët tona. Fondi i përgjithshëm leksikografik në gjuhën shqipe ngërthen mbi 500 vepra.

Ndër fjalorët kryesorë listohen: A. *Fjalori i gjuhës shqipe* (1954), b. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (1980), c. *Fjalori i shqipes së sotme* (1984). B. Arritje të mëdha shekullin e fundit kemi dhe në *Leksikografinë dygjuhëshe anglisht –shqip dhe shqip anglisht*, sepse hartimi i fjalorëve dygjuhësh doli si një drejtim kryesor në përputhje me rrethanat dhe me kërkesat e praktikës.

Në krahasim me gjuhën shqipe, fillesat e leksikografisë britanike janë më të hershme. Ato datojnë nga shekulli VII-VIII. Prej disa listash shpjeguese fjalësh, studiuesit shumë shpejt hartuan fjalorët e mirëfilltë. Fjalori i parë standard i përmasave të mëdha doli në qarkullim në shek. XVIII, nga Samuel Xhonsen. Në shek. XIX, *Fjalori i Oksfordit* dhe veprat leksikografike të Vebsterit, në Amerikë, do t'i jepnin pamjen e plotë leksikografisë së gjuhës angleze.

Fjalori është vepër gjuhësore që përmban një numër të madh fjalësh, të *renditura zakonisht alfabetikisht*, përkrah të cilave jepen shpjegimet për kuptimet e tyre leksikore ose gjegjëset në gjuhë të huaj.

Në gjuhën shqipe dallojmë fjalorët tradicionalë, ku kemi një fjalë titull, që *shpjegohet sipas mënyrës tradicionale* si kryeradhë dhe me struktura kuptimore të shtjelluara; dhe fjalorët me karakter çerdhor.

Këtu përmendim edhe fjalorët e mirëfilltë frazeologjikë dhe idiomatikë, që sipas kriterëve të ndryshme, mund të kenë elemente çerdhore ose jo. Për shembull: *Fjalori frazeologjik anglisht – shqip* i prof. Ilo Stefanllari nuk është ndërtuar me çerdhe idiomash apo njësisht frazeologjike por është ndërtuar si fjalorët e zakonshëm leksemorë. Kjo lehtëson dukshëm përdorimin e tij, sepse njësitë vendosen sipas rendit alfabetik.

Përsa i përket *Fjalori i gjuhës shqipe, 2006*, ai është fjalor praktik, me vëllim fizik sa fjalorët e Oxfordit etj., sa shpesh është quajtur *fjalori i vogël*, edhe pse ka 48.000 fjalë dhe 5.000 njësi frazeologjike. Ai është i pari fjalor shpjegues në të cilin janë përdorur elemente çerdhore, duke shfrytëzuar këtë lloj teknike leksikografike të përdorur me sukses në leksikografinë botërore dhe veçanërisht në atë angleze.

Fjalori i gjuhës shqipe, 2006, ka të paktën 12 lloje çerdhesh midis të cilave dallojmë çerdhe të *foljet veprorë* ku janë përfshirë edhe *foljet vetvetore, emrat e veprimit, mbiemrat prejpjesorë (dhe emërzimet e tyre, në qoftë se ka)*. Kështu, në qoftë se do të kishim paraqitjen tradicionale të fjalëve në një fjalor shpjegues do të kishim paragraf të veçantë për *hap, hapem, hapje, i hapur, e hapura, hapur*. 2. Si çerdhe shfaqen dhe fjalët e krijuara me konversion, zakonisht pjesët e pandryshueshme të ligjëratës si *ndajfolje, paraafjalë, lidhëz a pasthërmë*, të cilat vihen së bashku te njësia bazë, që mbart kuptimin e funksionin themelor, duke i ndarë edhe ato me një pikë të madhe të zezë. 3. Kemi çerdhe paradigmatiche fjalëformuese kur vihen bashkë me emrat përkatës edhe mbiemrat që lidhen me pjesëtarët e popullsisë a me banorët historikë të vendit, p.sh *shqiptar-i*. 4. Jepen në një çerdhe *mbiemrat së bashku me emërzimet e tyre*; p.sh. *komik/e*. 5. Janë

vendosur në një çerdhe emrat mashkullorë dhe femërorë, kur emrat femërorë janë formuar dhe janë motivuar morfematikisht drejtpërdrejt nga emrat mashkullorë dhe anasjelltas, p.sh. *balerin-i/a* 6. Formojnë çerdhe emrat me mbiemrat përkatës (kur ka të tillë) dhe ndajfoljet që lidhen me gjuhët; p.sh. *shqip-e*. 7. Krijojnë çerdhe me gjymtyrë minimale *mbiemrat me prapashtesën -shëm dhe ndajfoljet e formuara me këtë prapashtesë*; p.sh. *(i) dallueshëm*. 8. Krijojnë çerdhe me gjymtyrë minimale emrat me mbiemrat përkatës me temë të njëjtë me ta; p.sh. *etnografi-k*. 9. Krijojnë çerdhe me gjymtyrë minimale vargu emërtimet për numërorët themelorë me ato të numërorëve rreshtorë p.sh. *(i/e) tetë*. 10. Krijojnë çerdhe emërtimet e pathjeshta të bimëve, të kafshëve etj. bashkohen në një kuptim, me shënimin *bot*. dhe me formulën: “gjymtyrë e parë e emërtimeve të pathjeshta për disa bimë (kafshë...) të tilla”. 11. Formojnë çerdhe variantet foljore që mbarojnë me -t e me -s, ndajfoljet me prapashtesën -as dhe -azi, ndajfoljet dhe mbiemrat përkatës me një etj., p.sh. *ujit-je*. 12. Formojnë çerdhe ndajfoljet dhe mbiemrat përkatës me një etj. p.sh. *(i/e) saktë*.

Më 2008 doli në qarkullim *Fjalori themelor i gjuhës shqipe (dhe për shkollarët)* hartuar nga P. Qesku. Fjalori themelor i hartuar prej tij, me 25.000 fjalë të shqipes + 10.000 fjalë gjegjëse në gegërishte, ka shumë elemente çerdhore, që mendojmë se më shumë janë bërë nën ndikimin e përvojës leksikografike të anglishtes dhe të përvojës së vetë në leksikografinë dygjuhëshe, anglisht - shqip dhe shqip - anglisht.

Përsa i përket gjuhës angleze, ajo është një nga gjuhët më të përpunuara dhe më të zhvilluar sot në botë. Pothuajse të gjithë fjalorët e kësaj gjuhe kanë karakter çerdhor. Një nga fjalorët shpjegues të anglishtes, më të njohur për përdoruesin shqiptar të viteve 70-80 të shekullit XX është *Advanced Learner's Dictionary of Current English*, 1977 i hartuar nga A. S. Hornby. Në të kemi me qindra e mijëra çerdhe fjalësh. Përveç fjalës titull që jepet e plotë, në njësitë e tjera, qofshin shprehje, qofshin fjalë të përbëra me vizë lidhëse a pa vizë lidhëse ndërmjet dy gjymtyrëve, qofshin fjalë të prejardhura, fjala titull që është dhe temë fjalëformuese për të gjitha këto njësi jepet me tildë (~).

Megjithatë, mënyra e paraqitjes së fjalorëve shpesh nuk është unike. Kështu le të ndalemi në një nga dukuritë leksikore e semantike më të njohura në anglishte, tek *homonimia*.

Anglishtja është një gjuhë që ka shumë homonime, ndryshe nga shqipja, që ka rreth 1050 fjalë homonimike (rreth 500 çifte). Homonimet zakonisht ndahen në dy grupe të mëdha: në *homonime leksikore të plota* dhe *homonime jo të plota a të pjesshme*. Leksikografia shqipe dallon vetëm homoniminë e plotë, leksikore. Disa çerdhe nga më zakonshmet në paraqitjen e homonimeve janë: 1. *Homoformat*, nga të cilat më i njohur është sidomos çifti *emër / folje*. 2. *Në anglishte kemi çerdhe që përfshin fjalë me kuptim më të mëvetësishëm dhe fjalë me kuptim të mëvetësishëm*. Në leksikografinë shqiptare paraqitja e fjalëve në një fjalor shpjegues bëhet edhe sipas vlerave shënuese të fjalëve. Kështu në qoftë se në një çerdhe një fjalë del dhe si fjalë leksikore (si fjalë emërtuese) dhe si fjalë gramatikore (si fjalë shërbyese) fillimisht vendoset fjala leksikore mandej ajo

shërbyese. 3. Një çerdhe tjetër më e plotë është ajo që përfshin përveç njërive leksikore që dalin si nënzëra leksikografikë brenda zërit kryesorë të çerdhes, *edhe shumë fjalë që lidhen nga ana fjalëformuese me fjalën kryesore* (me fjalën titull). Çerdhet janë të vëllimeve të ndryshme: të vogla, të mesme, të mëdha. P.sh. fjala “high” krijon një nga çerdhet më të mëdha në gjuhën angleze. Përsa i përket hartimit të fjalorëve dygjuhësh, ai doli si një drejtim kryesor në përputhje me rrethanat dhe me kërkesat e praktikës. Në përgjithësi në fjalorët dygjuhësh shqip-anglisht nuk kemi elemente çerdhore, sepse hartimi i tyre ndjek teknikat e hartimit të fjalorëve nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave në Tiranë. Kështu që *elementet çerdhore më shumë i gjejmë në fjalorët anglisht – shqip* tek të cilët ndiqet tradita e çerdheve që ndeshen në të gjithë fjalorët shpjegues të anglishtes.

Studimet e sotme leksikore dhe semantike, që lidhen së pari me studimin e kuptimit leksikor dhe të lëvizjes kuptimore, nuk mund të realizohen si duhet nëse nuk mbështeten dhe në teorinë e fushave leksikore e semantike. Sipas prof. J. Thomait, “fushë quhet ajo tërësi lidhjesh të njërive gjuhësore që mbulohet nga një fjalë ose nga një grup fjalësh” J. Thomai vëren se “tërësia e leksemave që mbulon një fushë konceptuale dhe strukturën e lidhjeve kuptimore të tyre, formon *një fushë leksikore*”. Sipas studiuesit V. Memisha, në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980) gjejmë 4252 vargje paradigmantike ose fusha leksikore që kanë në qendër foljen si njësi fjalëformuese dhe motivuese, të cilat ndahen në vargje të plota dhe të paplota.

Në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, 2006, kemi një përmirësim të ndjeshëm. Të gjithë foljet janë dhënë përmes elementeve të një fjalori çerdhor dhe gati 90% e tyre janë dhënë në çerdhe me vargje gati-gati simetrike. Nëse dalim nga rrafshi leksikor dhe ndalemi në rrafshin semantik dhe në kuptimet që lidhen nga përbërës të ndryshëm atëherë gjendemi mes fushave semantike, të cilat ndahen në: a. *Makrofusha semantike*; b. *Fusha semantike*.

Njësitë që bëjnë pjesë në një çerdhe kanë lidhje fjalëformimi drejtpërdrejt a tërthorazi më fjalën që fillon vargun, edhe pse nuk ndodh gjithnjë kështu, si kemi folur shpesh për anglishten. a. Linja e parë që nënkupton madhësitë themelore që bëjnë vargun e hallkave themelore të formimit të fjalëve, të kalimit nga një si leksikore në tjetrën: *derivuesi – tema fjalëformuese – formanti fjalëformues – derivati*. b. Linja e dytë ndërtohet nga lidhjet kuptimore që vendosen ndërmjet *derivuesit* dhe *derivatit*, marrëdhënie ndërmjet njësisë motivuese dhe njësisë së motivuar semantiksht, me mbartjet dhe me ndryshimet e rrafshit kuptimor.

Ndërsa vargjet paradigmantike fjalëformuese brenda çerdheve në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, 2006, si dhe në të gjithë fjalorët me elemente çerdhore, i kemi dy llojesh: a. *Vargje të hapura* që nënkuptojnë mundësinë që të shtohen njësi të reja në mënyrë të papërcaktuar, pra vargje që nuk e ruajnë simetrinë e krijimit të njërive të reja. b. *Vargje të mbyllura*, të cilët kanë simetri formimi dhe numër të njëjtë gjymtyrësh, fjalësh të motivuara nga tema fjalëformuese *tip. Madhësitë* që

marrin pjesë në formimin e fjalëve të reja dhe në ngjizjen e kuptimit të tyre, në vargun fjalëformues janë tri a. Tema (ose rrënja) fjalëformuese;

b. Mjeti fjalëformues (ndajshesa); c. Ndërrimi i kategorisë leksiko – gramatikore. Modifikimet kuptimore, që përbëjnë thelbin e lëvizjeve kuptimore gjatë formimit të fjalëve, janë vlerë kryesive të ndajshesave dhe temave fjalëformuese. Çfarë ndryshimesh ndodhin në përmbajtje gjatë formimit të fjalëve?

a) Ndryshon kuptimi leksikor i veçantë, përndryshe nuk do të kishim një fjalë tjetër. b. Mund të ndryshojë kuptimi leksiko-gramatikor, pra, kuptimi kategorial, c. Mund të ndryshojë elemente të veçanta të përmbajtjes, që e bëjnë atë shumëvlerëshe nga ana e kuptimit kategorial. Në fakt në të gjitha çerdhet dallojmë qartë dy dukuri: a. Mbartje e plotë dhe e drejtpërdrejtë e strukturës kuptimore nga tema fjalëformuese të fjala e sapokrijuar; b. Mbartje me dukuri dhe ndërthurje nga më të ndryshmet, sidomos kur jemi në zhvillime që lidhen me çerdhet foljore, por dhe jo vetëm me këto.

Në gjuhën shqipe, te çerdhet foljore kemi dy pamje: a. Nëse folja ka zgjedhim të rregullt, atëherë dhe njësitë e formuara prej saj që zënë vend në çerdhe, gjenden me lehtësi.

b. Nëse fola ka zgjedhim të parregullt, atëherë vështirësia vjen ngaqë nuk kemi renditje alfabetike, por vendosje fjalëformuese, si te folja *ha* ku kemi *ha*, *hahem*, por *ngrënie*, i ngrënë.

Si përfundim mund të themi se lidhja midis shqipes dhe anglishtes po bëhet mjaft e ngushtë. Shqipja ka marrë, po merr e do të marrë fjalë e shprehje nga anglishtja, për njëherë apo për tjetrën arsye. Por huazimi duhet të jetë mundësisht i kontrolluar, sidomos për futjen e tyre nëpër fjalorë.

PËRFUNDIME

1. Nga mënyra se si paraqitet lënda leksikografike, brenda tyre, fjalorët mund të jenë alfabetikë fjalorë inversivëdhe çerdhorë. Këta janë tematiko-paradigmatikë dhe teamtiko-sintagmatikë.

2. Anglishtja është një nga gjuhët më të përpunuara dhe më të zhvilluar sot në botë. Fjalorët e kësaj gjuhe për efekte të ekonomisë gjuhësore kanë elemente çerdhore, d.m.th., që brenda një zëri leksikografik, përfshihet jo vetëm fjala titull e frazeologjia që lidhet me të, por edhe njësi të tjera leksikologjike (fjalë) që kanë lidhje prejardhjeje me fjalën titull. Edhe gjuha shqipe sot ka tashmë një fond të pasur veprash leksikografike (rreth 500), duke krijuar një traditë të vlerësueshme. Një nga këto përvoja është dhe hartimi i të parit fjalor me elemente çerdhore në shqipe, *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2006, botim i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e ndonjë fjalor tjetër si *Fjalor themelor i gjuhës shqipe* i P. Qeskut duke i përqasur me elementet çerdhore që gjenden në fjalorët më në zë të anglishtes.

3. Në një fjalor gjuhësor një gjuhësh apo dygjuhësh, çerdhet mund të jenë të përmasave të ndryshme, për nga lënda leksikore dhe semantike që përfshijnë brenda tyre. Kjo lidhet drejtpërdrejt me vlerat e fjalës në një gjuhë.

4. Elementet çerdhore në fjalorët e të dy gjuhëve nuk janë të njëllajta, as të njëjtave përmasa, sepse fjalorët ndryshojnë dhe teknikat dhe parimet e hartimit janë të ndryshme. Në *Fjalorin e gjuhës shqipe* kemi të paktën 12 lloje çerdhesh.

5. Çerdhet paradigmatike së pari i gjejmë në fjalorët integralë që përfaqësojnë fjalë dhe njësi frazeologjike (dhe idioma). Njësitë frazeologjike formojnë një çerdhe të vendosur në fund të fjalës titull. Gjithashtu në përdorim kemi dhe fjalorë të mirëfilltë frazeologjikë dhe idiomatikë, që sipas kritereve të ndryshme, mund të kenë elemente çerdhore ose jo. Prof. I. Stefanllari ka hartuar *Fjalorin frazeologjik anglisht – shqip*, i cili nuk është ndërtuar me çerdhe idiomash apo njësisish frazeologjike, por është ndërtuar si fjalorët e zakonshëm leksemorë. Kjo lehtëson dukshëm përdorimin e tij, sepse njësitë vendosen sipas rendit alfabetik, duke u mbështetur te struktura fonemore e gjymtyrës së parë.

6. Ne u ndalëm gjerësisht në fjalorët shpjegues të shqipes dhe të anglishtes. Një nga fjalorët shpjegues të anglishtes, më të njohur për përdoruesin shqiptar të viteve 70-80 të shekullit XX është *Advanced Learner's Dictionary of Current English*, 1977 i hartuar nga A. S. Hornby. Përveç fjalës titull që jepet e plotë, në njësitë e tjera, jepet me tildë (~).

7. Në 30 vjetët e fundit hartimi i fjalorëve në anglishte është kthyer në industri të mirëfilltë. Në të gjithë fjalorët, si kemi pohuar, kemi elemente çerdhore, por mënyra e paraqitjes së tyre shpesh nuk është unike. Kështu ne kemi trajtuar një nga dukuritë leksikore e semantike më të njohura në anglishte, tek *homonimia*. Anglishtja është një gjuhë që ka shumë homonime, ndryshe nga shqipja, që ka rreth 1050 fjalë (rreth 500 çifte). Por në fjalorë të ndryshëm të anglishtes, teknikat e paraqitjes së homonimisë janë të ndryshme nga ato të shqipes. Në anglishte kemi shumë homofoma, nga të cilat më i njohur është sidomos çifti *emër / folje*. Këtë çift e gjejmë shumë shpesh brenda një çerdheje, kur në shqipe gjymtyrët e këtij çifti jepen si zëra leksikografikë të veçantë.

8. Teknikat e ndryshme të paraqitjes së homonimisë në anglishte shumë shpesh mbarten edhe në fjalorët dy gjuhësh ku anglishtja është gjuhë e parë dhe zakonisht nuk mbahen parasysh zgjidhjet leksikografike të shqipes.

9. 20-30 vjetët e fundit kemi arritje të mëdha në *leksikografinë dygjuhëshe anglisht –shqip dhe shqip –anglisht*. Për nevojat e shkollës e të prodhimit u hartuan disa fjalorë shqip-gjuhë e huaj ose gjuhë e huaj-shqip. Në përgjithësi në fjalorët dygjuhësh shqip-anglisht nuk kemi elemente çerdhore, sepse hartimi i tyre ndjek teknikat e hartimit të fjalorëve nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave në Tiranë. Kështu që *elementet çerdhore më shumë i gjejmë në fjalorët anglisht – shqip*.

10. Në punim u shqyrtuan dhe *mjetet fjalëformuese* si dhe *marrëdhëniet semantike* që krijohen ndërmjet njësisë derivuese dhe njësisë së derivuar që përfaqësohen në një çerdhe. Sistemin e formimit të fjalëve që bëjnë pjesë në çerdhe, e përshkruajnë dy linja kryesore: linja e *madhësive themelore: derivuesi – tema fjalëformuese – formanti fjalëformues – derivati*, si dhe linja e *lidhjeve kuptimore* që vendosen ndërmjet *derivuesit dhe derivatit*.

11. Çerdhet u kundruan dhe si motivim kuptimor, duke u ndalur në elementet semantike që mbarten (semantemat) nga folja te njësitë e sapokrijuara. Gjatë kalimit nga njësi bazë te njësitë e sapokrijuara u panë *tërësia e ndryshimeve* ose *tërësia e lidhjeve* që ruan boshtin folje - folje vetvetore, folje - emër veprimi, folje - mbiemër prejppjesor, duke treguar se çdo njësi e sapokrijuar ka lidhje të drejtpërdrejta dhe të shumëfishta me foljen.

12. Si përfundim mund të themi se mënyra tradicionale e paraqitjes së lëndës leksikore si fjalës dhe shpjegimi kuptimor për çdo fjalë, në këta fjalorë nuk jepen vetëm në rend alfabetik, por edhe brenda çerdheve, që janë të përmasave të ndryshme. Kjo ka çuar në shtimin e lëndës brenda faqeve, por edhe e edukon përdoruesin të përdorë sa më shumë fusha konceptore dhe leksikore e semantike për të rritur në mënyrë sistematike kompetencën gjuhësore të tij. Sepse vënia në çerdhe leksikografike e emrave dhe e foljeve, e çdo njësie frazeologjike, e emrave femërorë sipas mashkullorëve, etj. konceptohen në bashkëlidhje dhe në asosacion, çka edhe psikologjikisht është shumë pozitive.

BIBLIOGRAFI

- A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën shqipe*, në “Çështje të gramatikës së shqipes së sotme”, II, Tiranë, 1975.
- A. Kostallari, Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare, në “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, Tiranë 1989; A. Kostallari, Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, 2, Tiranë, 1972.
- A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, në Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, 2, Tiranë, 1972.
- B. Nerlich, *Semantic theories in Europe 1830 - 1930*, Philadelphia, 1992.
- C. K. Ogden and I. A. Richards, *The meaning of meaning*, Orlando, 1989
- Collins, *English Grammar*, Oxford, 1990.
- D. A. Cruse, *Lexikal semantics*, Cambridge, 1986.
- E. Hysa, *Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare*, në “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”, Tiranë, 1988.
- E. Lafe, Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional, në “Konferenca shkencore Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 2003.
- E. Nida, *Exploring semantic structures*, Munchen, 1975.
- F. Agalliu, *Pjesorja në gjuhën shqipe në Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988
- F. de Saussure, *Cours de linguistique générale*, Paris, 1991.
- F. R. Palmer, *Semantics*, Cambridge, 1988.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980.

MIRELA PRIFTI

- Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954.
Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.
Fjalor i shqipe së sotme, Tiranë, 1984 / 2002.
Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2004.
- G. Leech..., A Communicative Grammar of English, Cambridge, 1991.
Huddelston, Introduction to the Grammar of English, Cambridge, 1989.
- I. Duro..., Fjalor shqip – anglisht, Tiranë, 1988.
I. Stefanllari, *Fjalor anglisht – shqip*, Tiranë, 1986.
I. Stefanllari, Fjalor frazeologjik anglisht – shqip, Tiranë, 1999.
- J. Lyons, Introduction to Theoretical Linguistics, Cambridge, 1975.
J. Lyons, Language, meaning, and context, London, 1981.
J. Lyons, *Semantics*, I, II, Cambridge, 1977.
J. Lyons, *Struktural semantics*, Cambridge, 1963.
- J. Saeed, *Semantics*, Pekin, 1997.
- J. Thomai, *Dukuri leksikore në shtypin e sotëm në Konferenca shkencore “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot”*, Tiranë, 2002.
- J. Thomai, *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*, në “Leksikografia shqipe - trashëgim dhe perspektivë”, Tiranë, 2006.
- J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2008..
- J. Thomai, Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe, Tiranë, 2009.
- J. Thomai, Rreth semantikës së foljeve veprare, pësore e vetvetore në gjuhën shqipe, GjJ, 1984, 3.
- J. Thomai, Shqipja standarde dhe leksikografia shqiptare, në “Konferenca shkencore Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 2003.
- J. Thomai, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992, f. 88.
- L. Lipke, Semantic structure and word-formation, Munchen, 1972.
- L. Newmark, Fjalor shqip – anglisht, Oxford, 1998.
- Longman, Dictionary of Contemporary English, Munchen, 1987.
- M. Çeliku, “Fjalor i shqipes së sotme”, 2002, dhe *Leksikografia shqiptare e ditëve tona*, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, 22/1, Prishtinë, 2004.
- N. Varfi, Introduction à la lexicologie du français, Tiranë, 2005.
New Horizons in linguistics, London 1972.
Oxford Advanced Learner’s Dictionary of Current English, Oxford, 1977.
Oxford Advanced Learner’s Dictionary, 2004.
Oxford Thesaurus of English, Oxford, 2004.
Oxford, Dictionary English-German & German English, 1998.
- P. Geci, *Pasuria e leksikut të shqipes dhe Fjalori i gjuhës shqipe*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, II, Tiranë, 1972 .
- P. Qesku, Fjalor shqip – anglisht, Tiranë, 2002.

ELEMENTE ÇERDHORE TEK FJALORË TË ANGLISHTES DHE TË SHQIPES

- R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2006.
- Robinson, *Language & social behaviour*, London, 1972 .
- S. Newmann, *Fjalor shqip – anglisht*, London, 1948.
- S. Ullman, *The Princips of semantics*, Oxford, 1963 .
- T. McArthur, *Concise Oxford Companion to the English Language*, Oxford, 1988.
- The New Oxford Dictionary of English, Oxford, 1999.
- V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejppjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999.
- V. Memisha, *Dukuria e polisemisë te foljet e prejardhura në gjuhën shqipe*, mbajtur në Seminarin ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare, Prishtinë, 2002.
- V. Memisha, *Për një fjalor të vogël të shqipes standarde*, në Seminarin III Albanologjik Ndërkombëtar, Shkup, 2009.
- V. Memisha, *Rreth normës leksikore e semantike të mbiemrave prejppjesorë në shqipe*, mbajtur në Seminarin ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare, Prishtinë, 2006.
- V. Memisha, *Rreth vargut fjalëformues folje - emër veprimi – mbiemër prejppjesor në fjalorët shpjegues te shqipes*, në Leksikologjia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë, Tiranë, 2005.